



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:020502
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05502584

A.C.nr.4015/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Hidajete Gashi-Alaj, dhe Arsim Hamzaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses V.V. nga Komuna Gjakovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Y.B, avokat me seli në Komuna Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Gjakovë, me objekt të padisë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.95/22 datë 31.01.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditëses V.V. nga Komuna Gjakovë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.95/22 datë 31.01.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.95/22 datë 31.01.2023, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“... I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses V.V. nga Gjakova, përmes së cilës ka kërkuar që të “detyrohet e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditëses të lartcekur, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 01.01.2015 e deri me datë 18.11.2016, të ia paguajë shumën prej 854.00.-€ (tetëqind e pesëdhjetë e katër euro), me kamatë ligjore

prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë, deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale”

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës...”

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditëses, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit, që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe kërkesëpadija e paditëses të aprovohet në tersi si e bazuar.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditëses është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja V.V. nga Komuna Gjakovë, me datë 31.01.2022, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Gjakovë, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit.

Gjykata e shkallës së parë me datë 31.01.2023, ka marrë aktgjykim C.nr.95/22 datë 31.01.2023, me të cilin ka vendosur që ta refuzojë në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka arsyetuar ndër të tjera si vijon: *“... Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që pretendimet e të autorizuarit të të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës, i morri si të bazuara pasi që sipas provave të administruara vërtetohet se paditësja kërkesën e saj për kompensimin në emër të ushqimit në punë e ka parashtruar pas afatit kohor prej 3 (tre) viteve siç parasheh neni 87 i Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i cili ka përcaktuar që “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, andaj në rastin konkret padia për këtë periudhë kohore është parashtruar me datë 31.01.2022 që nënkupton më shumë se tri vite nga lindja e të drejtës për kërkesën nga marrëdhënia e punës, përkatësisht lidhur me kompensimin e ushqimit në punë për periudhën kohore prej datës 01.01.2015 deri me datë 18.11.2016...”*

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe

nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditëses se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, si dhe duke u bazuar në nenin 399 paragrafi 1 të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *“ kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Janë vlerësuar pretendimet ankimore të paditëses, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4015/2023 datë 25.03.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Bujar Muzaqi